



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 20 Prot.

Vlorë më, 16. 02. 2017

V E N D I M

Nr. 26, datë 16. 02. 2017

*Bazuar në* nenin 30 e 38, pika 1, gërma "d", dhe 82 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë"; si dhe në nenin 9, pika 1, gërma "dh" dhe "g" të Statutit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë", miratuar me Urdhër nr. 586, datë 15.12.2016 të ministrit të Arsimit dhe Sportit;

*Me qëllim:*

- Mbështetur në prioritetet e qeverisë për arsimin profesional dhe veçanërisht edukimin fizik dhe sportet, si dhe nevojat rajonale;
- Zhvillimin normal të procesit të mësimdhënies bazuar në një strukturë akademike të miratuar;
- Bashkëpunim në institucione të tjera në funksion të plotësimit të nevojave të institucionit;

Senati Akademik i Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë",

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë projektin për hapjen e Programit të Studimit Bachelor në "**Edukim Fizik dhe Sporte**". Ky program të zhvillohet nga njësisia bazë Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Shkencave Shoqërore.
2. Projekti për hapjen e Programit të Studimit Bachelor në "**Edukim Fizik dhe Sporte**", t'i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Arsimit Privat, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, brenda afateve ligjore.



3. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit (Nr. 4 Prot, datë 03.02.2017), ndërmjet Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë" dhe Qendrës Kombëtare EPICT Albania TreCon IT "Për përfshirjen e Qendrës Kombëtare EPICT Albania TreCon IT si qendër e brendshme në Kolegjin Universitar "Pavarësia Vlorë, Qendra Kërkimore e Shkencave të Aplikuara".
4. Të konstituj Senatin Akademik, në përputhje me nenin 10 të Statutit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë", me këtë përbërje:
  1. Prof.Dr. Luan GJONÇAJ – Rektor / Kryetar;
  2. PhD. Siri HOXHA – Zv.Rektor / Zv.Kryetar;
  3. Prof. Dr. Muharrem DEZHGIU – Dekan i Fakultetit Ekonomisë & Shkencave Shoqërore / Anëtar;
  4. Prof.As.Dr. Ëngjëll LIÇAJ – Dekan i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara / Anëtar;
  5. Msc. Lindita LIÇAJ – Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike / anëtar;
  6. Dr. Rudina LIPI – Departamenti i Ekonomisë / Anëtar.
  7. Dr. Esmeralda HOXHA – Departamenti i Informatikës / Anëtar.
  8. Msc. Skerdilaid HYSENAJ – Departamenti i Arkitekturës / Anëtar.
  9. Andon LERA – Unioni Studentor/ Anëtar.
5. Miratimin e Strukturës Akademike të institucionit, sipas Shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij Vendimi.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Zëvendës Rektori, dekanët e Fakulteteve dhe Shefi i Zyrës së Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me Publikun dhe Shërbimet.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## K R Y E T A R I

**Prof. As. Dr. Luan GJONÇAJ**

